

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1727 Rep.
Nr. 805 Kol.

**KONTRATE
SHITIE KUOTASH**

Ne Tirane, sot ne daten 18/04/2018 (dymije e h e t e m b e d h j e t e), perpara meje noterit publik Ermal Xh. HAMZAJ, Anetar i Dhomes se Notereve Tirane, me license profesionale nr.511, ne zyren time noteriale me adrese Rr: "Ismail Qemali", Nd.4, H.1 Tirane, u paraqiten personalisht shtetasit:

Z. Mihal DUNI, atesia Spiro, i datelindjes 09.08.1965, lindur ne Shkoder dhe banues ne Athine Greqi, ne adresen Iron Politeknio 20, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi te plote për të vepruar, i pajisur me Leternjoftimin Nr 030107974 dhe Nr Personal G50809044C; referuar me poshte si "Shitesi";

dhe

Z. Florenc GJIKURIA, atesia Milo, shtetas shqiptar, lindur ne Memaliaj, Tepelene, me 12.01.1973 banues ne Tirane, Shqiperi, i pajisur me Leternjoftimin Nr 031406006 dhe Nr Personal H30112106D, referuar me poshte si "Bleresi".

MEQENESE ekzistojne faktet:

Z. Mihal DUNI eshte ortak i shoqerise "**GJIKURIA**" SHPK, shoqeri tregtare e se drejtes Shqiptare, e regjistruar ne QKR me date 16/03/1993, me NIPT/NUIS J62903456H, me zyre qendrore ne adresen TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Prane Gardes se Republikes, Pallati Kontakt, mbi Union Bank dhe zoteron 89.080 pjese qe perfaqesojne 40% te kapitalit te shoqerise.

Z. Mihal DUNI deklarone se deshiron te shes teresisht te gjitha kuotat qe zoterone ne shoqeri, qe perfaqesojne 40% te kapitalit te shoqerise, ortakut ekzistues z. Florenc GJIKURIA, sipas kushteve te meposhtme.

Z. Florenc GJIKURIA, deshiron ti bleje Z. Mihal DUNI teresisht te gjitha kuotat e zoteruara prej tij ne shoqeri, qe perfaqesojne 40% te kapitalit te shoqerise, sipas kushteve te meposhtme.

Palet e mesiperme me vullnet te lire dhe te plote, me kerkuan mua noterit hartimin e kesaj kontrate shitje kuotash, me permbajtjen si me poshte :

**Neni 1
Qellimi i kontrates**

- Qellimi i kesaj kontrate eshte transferimi i pronesise te kuotave ne kapitalin e shoqerise nga shitesi tek bleresi.
- Kjo kontrate sherben per percaktimin e kriterëve, procedurave dhe menyres se transferimit te pronesise dhe pageses perkatese lidhur me kete transferim.
- Ne percaktim te kushteve, palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

**Neni 2
Objekti i kontrates**

- Nepermjet kesaj kontrate, shitesi transferone ne favor te bleresit te gjitha kuotat e zoteruara prej tij ne shoqeri, te cilat perfaqesojne ne total 40 % te kapitalit te shoqerise, ne baze te cmimit te percaktuar ne nenin 3 me poshte.

-Gjithashtu, bleresi do te blej nga shitesi teresisht te gjitha kuotat e zoteruara prej tij ne shoqeri, te cilat perfaqesojne ne total 40 % te kapitalit te shoqerise, ne baze te cmimit te percaktuar ne nenin 3 me poshte.

Neni 3 **Çmimi dhe menyra e pagimit**

-Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre qe çmimi i shitjes te te gjitha kuotave qe shitesi transferon ne favor te bleresit, te cilat perfaqesojne ne total 40 % te kapitalit te shoqerise do te jete **LEKE 2.526.720** (dymilion e peseqind e njezet e gjashtemije e shtateqind e njezet leke).

-Po ashtu, te dyja palët deklarojnë se shuma e mësipërme i është shlyer teresisht pales shiteses nga ana e pales blereses perpara nenshkrimit te kesaj kontrate jashte zyres noteriale dhe se nuk kane asnje pretendim financiar kundrejt njeri tjetrit.

Neni 4 **Pergjegjesite dhe garanci te paleve**

Shitesi nepermjet kesaj kontrate per shitje kuotash garanton si me poshte:

- a) se eshte i vetmi titullar i ligjshem i kuotave qe po trasferohen me kete kontrate shitje;
- b) se kontributi monetar i derdhur prej tij per zoterimin e kuotave, objekt te kesaj kontrate shitje ben pjese ne pasurite vetjake ne referim te nenin 77 te Kodit te Familjes ne fuqi.
- c) se kuotat objekt shitje jane plotesisht te lira nga cdo barre, detyrim, te drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjetër.
- d) ortaku z. Mihal Duni deklaroi nen pergjegjesine e tij personale se me nenshkrimin e ketij akti noteriale, ai heq dore ne menyre te parevokueshme nga te gjitha te drejta qe i kane takuar ne cilesine e ortakut dhe administratorit ne shoqeri, apo cdo te drejte tjetër pa kufizim ku perfshihen te drejta pune, dividenti etj, duke mos pasur me asnje pretendim financiar te sotem apo te ardhshem ndaj shoqerise "GJIKURIA" SHPK apo dhe te gjithë ortakëve te tjere te saj.
- e) Gjithashtu ortaku Mihal Duni deklaroi nen pergjegjesine e tij personale se nje plotesisht te vlefshme te gjitha vendimet e asamblese te ortakëve te shoqerise "GJIKURIA" SHPK te nenshkruara nga ortakët gjate gjithë veprimtarise te shoqerise si dhe pasojat ligjore te ketyre vendimeve, posaçerisht marrëdhënieve me "BANKA CREDINS" SHA, me NIPT K316088010, duke mos pasur me asnje pretendim, te sotem apo te ardhshem ne lidhje me keto vendimarrje.

NENI 5 **Efektet e kontrates**

-Kjo kontrate ka fuqine e ligjit per palet nga momenti i nenshkrimit te saj perpara noterit dhe mund te ndryshohet vetem me marreveshje me shkrim dypaleshe.

-Kontrata ka efekt per palet e treta ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 6 **Informacioni konfidencial**

-Palet detyrohen te mbajne konfidencial te gjithë dokumentacionin, te dhenat dhe cdo informacion te perfituar gjate marrëdhënieve se tyre ne shoqeri apo dhe referuar marrëdhënieve konkrete te krijuar me kete kontrate.

NENI 7 **Transferimi i te drejtave**

-Menjehere mbas nenshkrimit te paleve, kontrata do te depozitohet dhe regjistrohët nga bleresi prane regjistrin tregtar te QKR.

-Me nenshkrimin e kesaj kontrate, kapitali i shoqerise do te zoterohet 100% nga ortakët ekzistues ne raportet si me poshte:

- Florenc Gjiguria zoteron 64 % te kapitalit te shoqerise;
- Milo Gjiguria zoteron 36 % te kapitalit te shoqerise;

NENI 8

Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente

- Kontrata eshte hartuar ne perputhje me Legjislacionin tregtar ne fuqi.
- Blëresi dhe shitesi angazhohen te bejne cdo perpjekje per zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konfliktet te mundshme qe mund te krijohen midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negociemeve te drejteperdrejta.
- Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konflikteve midis tyre, ceshtja do ti nenshtrohet juridiksionit gjyqesor.

NENI 9

Dispozita perfundimtare

- Kjo kontrate eshte hartuar ne 4 (kater) kopje, ne gjuhen Shqip, me vlere te njejte ligjore nga nje per seicilen pale, e cila ju lexua me ze te larte e te qarte paleve nga une noteri ne gjuhen Shqip.
- Palet deklaruan se e degjuan, e kuptuan dhe meqenese kontrata eshte hartuar ne perputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nenshkruan personalisht dhe pa verejtje perpara meje noterit.
- Pas nenshkrimit te paleve, une noteri e nenshkrova dhe e vertetova kontraten sipas kerkesave te ligjit Nr.7829, date 01.06.1994 "Per Noterine ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar).

Gjithashtu palët autorizojnë mua noterin për përdorimin e të dhënave personale të tyre të bëra të ditura sa më sipër dhe se të dhënat e përdorura nga unë noteri në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e redaktimit të këtij akti. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 - i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

PALET KONTRAKTORE


SHITESI

Mihal DUNI




BLERESI

Florenc GJIKURIA



NOTERI

Ermal Xh.HAMZAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTER ERMAL XH.HAMZAJ
Nr. 1894 REP.



VËRTETIM

Në Tiranë, sot në datën 30/04/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), përpara meje Ermal Xh. Hamzaj, Noter në qytetin Tiranë, Anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me Liçensë profesionale Nr. 511, në zyrën time noteriale me adresë Rr: "Ismail Qemali", Nd. 4 , H. 1 , Njësia Bashkiake Nr. 5, u paraqit personalisht ,

Z/Znj. Elton Dema , madhor/e, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës/e i/e Letërnjoftimit/Pasaportë Nr.personal Gj. Kumishta dhe paraqiti dokumentin original dhe kete fotokopje te dokumentit (bashkelidhur me vertetimin), duke kerkuar vertetimin e kesaj fotokopje me dokumentin origjinal te paraqitur si me sipër:

Kontrakti shitjei kuotesh Nr 1727 Rep, Nr 805 tof
date 18/04/2018 - Noter Ermal Hamzaj

Pas verifikimit, në përputhje me Nenin 56 te ligjit 7829, datë 01.06.1994 "Per Noterine ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar) dhe Udhezimin e Ministris se Drejtësisë Nr. 6291, date 17.08.2005, pika 3,4,7, vërtetoj se fotokopja e dokumentit bashkëlidhur me kete vertetim, është e njëjte me dokumentin origjinal të paraqitur si më sipër. Në të nuk dallohen korrigjime, shtesa, fshirje a shenja të tjera të veçanta.

NOTERI

Ermal Xh. Hamzaj

NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ

